



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Kaçanik
Skupština Opština
Municipal Assambly
01Nr.03-9812/2010
Kaçanik,28.12.2010

Në bazë të nenit 12, pika 12.2(d), nenin 17.1(j) lidhur më nenin 40.2(l) të Ligjit nr. 03/L – 040- Për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 28, pika 28.3, të nenit 40, pika 40.2 dhe nenit 50, pika 50.1 dhe 50.3 të Ligjit nr. 2004/31 - Për Shëndetësi në Kosovë, të Rekomandimit të KPF-a të datës 23.12.2010 për aprovimin e Draft-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Kaçanik të propozuar nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Kuvendi i Komunës së Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më 28.12.2010, miratoi:

S T A T U T I N

E QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE

NË KOMUNEN E KAÇANIKUT

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

1.1. Më këtë Statut rregullohet: emërtimi dhe selia, veprimtaria, statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi, struktura e Qendrës, sistemi i informimit shëndetësor, udhëheqja dhe trupat e Qendrës, zhvillimi i vazhdueshëm profesional, mbikëqyrja, aktet e përgjithshme, pronësia dhe financimi, transparenca, konfidenca profesionale dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së kujdesit shëndetësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (në vazhdim të tekstit: QKMF).

1.2.Themelues i QKMF-së është Kuvendi i Komunës së Kaçanikut.

Neni 2

QKMF- ja ka statusin e personit juridik, ku organizohet, ofrohet dhe zbatohet kujdesi parësor shëndetësor.

Neni 3

3.1.QKMF - ja ka në dispozicion mjetet dhe pasurinë, të cilat i përkasin Komunës.

3.2. QKMF- ja si institucion i kujdesit parësor shëndetësor, është përvetësuese e fondit për financim të saj nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

II. Emërtimi dhe selia

Neni 4

4.1.Emri i institucionit është: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dëshmoret e Lirisë” në Kaçanik.

4.2.Shenja njohëse, Emblema - logo e QKMF - së, do të dizajnohet nga QKMF - ja dhe do të miratohet nga DSHMS - ja.

4.3. Emërtimi i QKMF – së, Qendrës së Mjekësisë Familjare dhe Ambulancës së Mjekësisë Familjare duhet të jetë i vendosur në objekt, në të cilin kryhet veprimtaria shëndetësore parësore, në gjuhët zyrtare në përdorim në Kosovë.

4.4.Për ndryshimin e emrit dhe të selisë së QKMF - së vendos Kuvendi i Komunës.

Neni 5

Selia e QKMF - së është në Kaçanik, rruga “Emin Duraku”, nr. 142.

Neni 6

6.1. QKMF - ja ka vulën e saj, që në qarkullimin juridik paraqitet si: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dëshmoret e Lirisë” Kaçanik.

6.2. Vula e rrumbullakët është me diametër 2.5 cm dhe ka këtë përmbajtje:

- Rrethi i parë: **Republika e Kosovës**;
- Rrethi i dytë: **Komuna e Kaçanikut**;
- Rrethi i tretë: **Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dëshmoret e Lirisë”**;
- **Njësia e QKMF – së**;
- Në mes të vulës është **emblema (logo)**.

6.3. Vula katrore, e pranimit dhe e dorëzimit, është e madhësisë 7 x 2.5 cm, me përmbajtje:

- **Republika e Kosovës**;
- **Komuna e Kaçanikut**;
- **Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Dëshmoret e Lirisë”**;
- **Njësia organizative, numri dhe data e evidencës**.

6.4. Vula duhet të përmbajë emërtimin e institucionit dhe selinë, të shkruar në gjuhët zyrtare që janë në përdorim në Kosovë.

6.5. Secila njësi e QKMF – së ka vulën e vetë me numrin identifikues.

6.6. Për numrin e vulave, mënyrën e përdorimit dhe autorizimin e personit për përdorim dhe ruajtjen e tyre, vendos drejtori.

III. Veprimtaria e QKMF - së

Neni 7

7.1. Veprimtaria e QKMF - së përfshinë ofrimin e kujdesit parësor shëndetësor për banorët e komunës, si një veprimtari me interes të veçant shoqëror, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës.

7.2. Koncepti i mjekësisë familjare konsiston në atë që banorëve të komunës t’iu ofrojë kujdes shëndetësor gjithëpërfshirës dhe efikas, të bazuar në të dhëna shkencore, përmes caktimit të mjekut familjar, i cili për pacientët do të jetë “portë hyrëse ” në sistemin shëndetësor dhe, njëherësh pikë referuese për specialistët konsultantë në kujdesin parësor dhe në nivele tjera të kujdesit shëndetësor (dytësor dhe tretësor).

7.3. Sipas strategjisë dhe standardeve të mjekësisë familjare, synohet që një mjek familjar të ushtrijë kujdes shëndetësor për 2000 deri në 2500 banorë, sipas shtrirjes territoriale, gjeografike dhe organizimit të QKMF - së. Këto standarde do të jenë subjekt i revidimit periodik nga ana Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

7.4. Kujdesi shëndetësor në QKMF sigurohet dhe zbatohet nga punonjësit, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për Punë, në përbërje nga:

- a) specialistë të mjekësisë familjare,
- b) specializatë të mjekësisë familjare doktorë të mjekësisë,
- c) doktorë të stomatologjisë,
- d) infermierë,
- e) teknikë të mjekësisë,
- f) mami,
- g) teknikë të laboratorit,
- h) teknikë të Ro kabinetit.

7.5. Kujdesi shëndetësor në QKMF përkrahët nga specialistët konsulentë ekzistues pranë QKMF - së, si:

- a) specialisti i stomatologjisë (preventive);
- b) pediatri;
- c) gjinekologu;
- d) specialisti i biokimisë klinike dhe
- e) specialistët ekzistues të lëmenjve të tjerë.

Neni 8

8.1. Kujdesi parësor shëndetësor përfshinë:

- a) Parandalimin, mjekimin, shërimin dhe rehabilitimin e pacientëve nga sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet;
- b) Edukimin shëndetësor, imunizimin dhe vaksinimin;
- c) Përcaktimin e diagnozës fillestare dhe kujdesin elementar shëndetësor, përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike;
- d) Promovimin e shëndetit oral dhe kujdesin themelor stomatologjik;
- e) Kujdesin për shëndetin mendor, bazuar në bashkësi;
- f) Rehabilitimin e bazuar në bashkësi;
- g) Kujdesin shëndetësor riprodhues, që përfshinë kujdesin shëndetësor gjatë shtatzënisë, lindjes dhe të lehonave, si dhe metodat e planifikimit të familjes;
- h) Zbulimin e hershëm të sëmundjeve ngjitëse;
- i) Kryerjen e shërbimeve specialistike, diagnostike (analiza laboratorike, rëntgenologjike si dhe testet tjetra) në kujdesin parësor shëndetësor;
- j) Edukimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punonjësve;
- k) Hulumtimin shkencor.

IV. Statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi

Neni 9

9.1. QKMF - ja në Kaçanik është institucion, i cili bën pjesë në rrjetin e institucioneve shëndetësore publike.

9.2. QKMF - ja kryen dhe ofron shërbime të kujdesit parësor për banorët e komunës sipas parimit të kujdesit shëndetësor, të përcaktuar me dispozitat e këtij Statuti, të Ligjit për Shëndetësi dhe të dispozitave tjera ligjore.

9.3. Për nënshkrimin e kontratave, me të cilat fitohen, tjetërsohen apo shiten objektet, pajisjet (kapitale) e QKMF - së, QKMF - ja së pari duhet ta ketë miratimin e themeluesit.

9.4. Në rast të nënshkrimit të kontratave nga pika 9.3, QKMF - ja paraqitet si subjekt i pavarur juridik dhe afarist, bazuar në Ligjin për prokurim publik dhe në aktet nënligjore të cilat i nxjerr Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

9.5. Për përgjegjësitë e marra financiare, QKMF - ja përgjigjet me tërë pasurinë e saj.

9.6. Themeluesi i QKMF - së përgjigjet për obligimet e saj.

9.7. Qarkullimi i mjeteve financiare bëhet përmes xhironlogarisë së Komunës dhe nën llogarisë së caktuar për QKMF –në.

Neni 10

Drejtori i QKMF - së ka të gjitha autorizimet për përfaqësimin juridik dhe afarist, brenda veprimtarisë së QKMF - së, duke marrë parasysh përkufizimet e këtij Statuti dhe të ligjit.

V Struktura e institucionit

Neni 11

11.1. QKMF - ja, për realizimin e funksionimit të shëndetësisë parësore dhe sigurimin e mbrojtjes së mirëfilltë shëndetësor të banorëve, është organizuar nëpërmjet këtyre sektorëve:

1. Sektori i Mjekësisë Familjare: konsultativ dhe diagnostikues;
2. Sektori i Shëndetit Publik: Sistemi i informimit shëndetësor, imunizimit dhe vaksinimit;
3. Sektori i Shëndetit Oral;
4. Barnatorja e QKMF-së dhe
5. Sektori i Administratës:

- a) Zyra për buxhet dhe financa,
- b) Zyra e personelit dhe juridike,
- c) Zyra për shërbime teknike.

11.2 Dispozitat më të hollësishme për organizimin e brendshëm të QKMF - së, përcaktohen me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

11.3 Lista e Qendrave të Mjekësisë Familjare dhe ambulancave të mjekësisë në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Kaçanik, përbën rrjetin e institucioneve:

- a) Qendra e Mjekësisë Familjare në Bob
- b) Qendra e Mjekësisë Familjare në Kaçanik të Vjetër me Ambulancat Familjare në Begracë dhe Stagovë.
- c) Qendra e Mjekësisë Familjare në Doganaj me Ambulancat Familjare në Dubravë dhe Biqec dhe
- d) Qendra e Mjekësisë Familjare në Gllloboqicë me Ambulancat Familjare në Kotlinë dhe Strazhë.

11.4. QKMF-ja zbaton sistemin unik të informimit shëndetësor, ashtu siç është paraparë me Ligjin e shëndetësisë dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë lëmi.

11.5. Për qëllime të sistemit të informimit shëndetësor, Ministria, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS) dhe QKMF - në, do të zhvillojë një sistem unik të kodeve për të gjitha QMF – të, AMF – të dhe sektorët e saj.

11.6. Sistemin e informimit shëndetësor në QKMF-ë e përbëjnë:

- a) sistemi i evidencave, me të cilin rregullohet evidencimi i të dhënave;
- b) sistemi me të cilin rregullohet dërgimi, gjegjësisht grumbullimi i të dhënave, përpunimi dhe publikimi i tyre.

11.7 QKMF - ja bën mbledhjen, evidencimin dhe vendosjen e të dhënave statistikore në sistemin e informimit shëndetësor (SISH) në programin kompjuterik të Ministrisë, i cili përmban të dhënat e nevojshme për shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore.

11.8 QKMF-ja pas mbledhjes, evidencimit dhe vendosjes së të dhënave statistikore, është e obliguar që, përmes raporteve periodike dhe formularëve të përcaktuar nga Ministria, t'i dërgojë ato në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe të Mirëqenies Sociale, dhe organeve të autorizuar të Ministrisë së Shëndetësisë.

11.9 Secili profesionist shëndetësor gjatë raportimit duhet të sigurojë fshehtësinë profesionale, duke mos cenuar të drejtat e pacientit, përveç rasteve të rregulluara me ligj.

VI. Udhëheqja dhe trupat e QKMF-së

Këshilli drejtues

Neni 12

Këshilli drejtues drejton aktivitetet e QKMF - së, nën udhëheqjen e drejtorit.

Neni 13

13.1. Këshilli drejtues ka 7 (shtatë) anëtarë:

1. drejtori i QKMF- së, i cili e kryeson Këshillin,
2. kryeshefi i Mjekësisë Familjare,
3. kryeinfermierja e QKMF - së,
4. udhëheqësi i Sektorit të administratës,
5. udhëheqësi i Sektorit të financave.
6. udhëheqësi i Sektorit të shëndetit publik,
7. udhëheqësi i Sektorit të Stomatologjisë

13.2. Mandati i anëtarëve të Këshillit zgjat 3 vjet, me mundësi të vazhdimit të mandatit.

Ky mandat mund të përfundojë edhe më parë, në rast se:

- a) ndërpritet marrëdhënia e punës në QKMF;
- b) tregon mosrespektim të obligimeve të punës.

Neni 14

Këshilli drejtues kryen punët, të cilat parashihen me këtë Statut dhe vendos për:

- a) veprimtarinë e QKMF-së dhe vërteton politikën e punës së QKMF - së;
- b) propozimin e ndryshimeve të Statutit të QKMF – së;
- c) miratimin e raportit të punës dhe llogaritë vjetore të QKMF- së;
- d) shfrytëzimin e mjeteve në kuadër të ligjit;
- e) nxjerrjen e programit të punës dhe planit financiar;
- f) miratimin e rregullores për organizimin e punës në QKMF dhe akte të tjera në përputhshmëri me ligj dhe Statut;
- g) hartimin e planit të burimeve njerëzore sipas propozimit të Këshillit profesional, brenda resurseve në dispozicion dhe në përputhje me nevojat e shërbimit;
- h) miratimin e çmimeve që i ofron QKMF- ja për shërbimet shëndetësore, të cilat nuk janë të përcaktuara nga ana e Ministrisë;
- i) hartimin e planit për furnizim të QKMF- së dhe vendos për dhënien në shfrytëzim të lokaleve dhe mjeteve të veçanta;
- j) hartimin e planit dhe programit të masave për mbrojtje në punë;
- k) mbarëvajtjen e punëve;
- l) emërimin e komisioneve të përkohshme dhe të organeve tjera punuese;
- m) sigurimin e pasurisë së QKMF- së, sigurimin e punëtorëve në bazë të ligjit;
- n) propozimin për ndërtimin dhe adaptimin e objekteve, si dhe për burimet e mjeteve për kryerjen e këtyre punimeve, duke u bazuar në politikën shëndetësore;
- o) shqyrtimin e njoftimeve për mbikëqyrjen e raporteve të përkohshme mbi punën profesionale;
- p) punë të tjera, të cilat i janë lënë në kompetencë me këtë Statut dhe akte të tjera normative të QKMF- së.

Neni 15

15.1 Këshilli drejtues merr vendim kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve.

15.2 Në mbledhjen e Këshillit drejtues mbahet procesverbal, ekstraktin e të cilit pjesëmarrësit e shqyrtojnë dhe e miratojnë në mbledhjen vijuese.

15.3 Këshilli drejtues nxjerr rregulloren e punës të QKMF - së, me të cilën rregullohen më hollësisht çështjet në lëmin e punës, të cilat nuk janë të rregulluara me ligj, e as me këtë Statut.

Neni 16

16.1 Drejtori është përgjegjës për ushtrimin e kompetencave të përcaktuara për QKMF - në. E prezanton dhe e përfaqëson QKMF – në.

16.2 Në rast se mungon drejtori, QKMF - në e përfaqëson Kryeshefi i Mjekësisë Familjare.

Drejtori mund t'i bart disa përgjegjësi te personat e tretë, me pëlqim të drejtorit të DSHMS – së.

Neni 17

17.1. QKMF - në e udhëheq drejtori i QKMF - së.

17.2. Drejtorinë e QKMF – së, me pëlqimin e drejtorit të DSHMS, e cakton Kryetari i Komunës, në kohëzgjatje për 3 vjet, me mundësi të vazhdimit në pajtim me Ligjin që rregullon punësimin në institucionet shëndetësore.

17.3. Drejtor i QKMF - së mund të zgjidhet personi i cili i plotëson kushtet e caktuara në pikën 2 dhe duhet të jetë mjek specialist i mjekësisë familjare dhe të ketë 5 vjet përvojë pune në shëndetësi. Përparësi iu jepet kandidatëve me përvojë në procesin e zbatimit të mjekësisë familjare, trajnimeve në menaxhment shëndetësor dhe shëndetësi publike.

17.4. Kryeshefi i Mjekësisë Familjare i QKMF - së caktohet kandidati i cili i plotëson kushtet e parapara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

17.5. Kryeshefi i Mjekësisë Familjare kryen punët të cilat i cakton drejtori i QKMF - së. Në mungesë të drejtorit, ai i ka të gjitha autorizimet e drejtorit të QKMF- së.

Neni 18

18.1. Vendimin për shpalljen e konkursit për drejtor të QKMF - së e merr Kryetari i Komunës.

18.2. Kryetari i Komunës autorizon drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të shpallë konkursin për drejtor dhe Kryeshef të Mjekësisë Familjare të QKMF - së.

Neni 19

19.1. Drejtori i QKMF - së është përgjegjës për të siguruar ligjshmërinë dhe punën profesionale të QKMF - së, e cila duhet të organizohet dhe të udhëhiqet në pajtim me dispozitat e këtij Statuti dhe dispozitat ligjore.

19.2. Drejtori i QKMF - së është përgjegjës për përkujdesjen eficiente dhe efektive të shëndetësisë parësore për të gjithë banorët e komunës së Kaçanikut dhe përgjigjet për detyrat në vijim:

a) Në pajtim me politikën shëndetësore, Ligjin për shëndetësi në Kosovë dhe Strategjinë e kujdesit parësor shëndetësor, i propozon Drejtorisë së Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale planin e punës dhe buxhetin e QKMF - së për vitin vijues;

b) Në mbikëqyrjen dhe autorizimin e drejtorit të DSHMS, zbaton buxhetin e QKMF - së;

c) Është përgjegjës për:

- zbatimin e planit të burimeve njerëzore sipas nenit 14, shkronja g,
- udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në QKMF,
- zhvillimin e marrëdhënieve të mira me donatorët dhe OJQ-të,
- zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe trajnimin e personelit të QKMF - së,

vendosjen e mekanizmave të sigurimit të cilësisë në objektet e KPSH - së të komunës, • dhënien e kontributit për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor të QKMF - së, sipas standardeve të pranuar, dhe sigurimin e mbledhjes së informatave dhe avancimin e punës ekipore.

19.3 Programi i punës së QKMF - së realizohet duke u bazuar në politikat zhvillimore të sistemit shëndetësor të nxjerra nga Ministria.

19.4 Në programin vjetor të punës duhet të përcaktohen: masat, aktivitetet dhe rezultatet e pritura të kujdesit shëndetësor në QKMF:

- a) plani vjetor i punës,
- b) organizimi dhe udhëheqja,
- c) burimet njerëzore,
- d) plani financiar,
- e) raportet mujore, vjetore të punës dhe raportet financiare.

19.5 Drejtori i QKMF - së për kryerjen e punëve të tij, iu përgjigjet drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Kryetarit të Komunës.

Neni 20

Drejtori ka për detyrë që gjatë punës t'ia tërheq vërejtjen Këshillit drejtues për vendimet që mund të marrë, siç janë:

- a) aktet e propozuara, të cilat janë në kundërshtim me ligjet relevante, respektivisht aktet e përgjithshme të QKMF – së;
- b) akti i propozuar, i cili është në kundërshtim me programin e punës së QKMF - së;
- c) akti i propozuar, i cili nuk i kontribuon qëllimit.

Trupat e QKMF - së

Neni 21

21.1. Për përmbushjen e detyrave të veçanta, Këshilli drejtues, përmes drejtorit të QKMF - së, formon trupa profesionale pranë QKMF - së, siç janë:

- Këshilli profesional,
- Kolegji profesional,
- Komisionin disiplinorë dhe i ankesave i QKMF – së,
- Komiteti për sigurimin e cilësisë në shërbime,
- Komiteti për zhvillim të vazhdueshëm profesional,
- Komisioni etikë - profesional etj.

21.2. Këshilli drejtues, përmes drejtorit të QKMF - së, sipas nevojës, mund të formojë edhe trupa të tjera profesionale pranë QKMF - së.

Këshilli profesional

Neni 22

22.1. Këshilli profesional është trupë këshillëdhënëse për drejtorin e QKMF - së.

22.2. Këshilli profesional përbëhet nga udhëheqësit nga neni 11 i këtij Statuti.

22.3. Kryesuesi i Këshillit profesional, sipas detyrës zyrtare, është kryeshefi i Mjekësisë Familjare të QKMF - së.

22.4. Këshilli profesional nxjerr Rregullorën e punës për punën e Këshillit.

Neni 23

23.1 Kryesuesi i Këshillit profesional i kryen këto punë:

- a) Përgatit, thërret dhe udhëheq mbledhjet e Këshillit profesional;
- b) Verifikon rendin e ditës së mbledhjeve dhe
- c) Siguron mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes.

23.2 Kryesuesi i Këshillit profesional është i obliguar ta thërras mbledhjen me kërkesën e Këshillit drejtues dhe të drejtorit të QKMF – së.

Neni 24

Këshilli profesional i QKMF - së kryen këto punë dhe detyra:

- a) Diskuton dhe vendos për nevojën dhe arsyet profesionale të zbatimit të metodave dhe procedurave të reja diagnostifikuese dhe terapeutike;
- b) I propozon Këshillit Drejtues dhe drejtorit, marrjen e masave profesionale për përmirësimin e organizimit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë;
- c) Propozon strukturën e mbikëqyrjes së brendshme lidhur me punën e punëtorëve shëndetësor dhe masat për përmirësimin e punës profesionale;
- d) Shqyrton nevojën për zhvillim profesional dhe i propozon drejtorit dërgimin e punëtorëve shëndetësorë për ngritje profesionale;
- e) Shqyrton dhe vendos lidhur me çështjet tjera, të cilat drejtori ia parashtron Këshillit profesional.

Kolegji profesional

Neni 25

25.1. Me qëllim të shqyrtimit të çështjeve në lëmin e punës profesionale në çdo sektor, nga neni 11 i këtij Statuti, themelohet Kolegji profesional.

25.2. Kolegjin profesional e përbëjnë:

- a) udhëheqësit, sipas nenit 11 të këtij Statuti

25.3. Kolegji profesional i kryen këto punë:

- a) Shqyrton çështjet lidhur me udhëheqjen e punës profesionale në sektor dhe njësi, merr qëndrim dhe propozon lidhur me zgjidhjen e këtyre çështjeve;
- b) I propozon Këshillit profesional, përmes shefit të Sektorit, nevojën dhe arsyeshmërinë profesionale të zbatimit të metodave të reja diagnostifikuese dhe terapeutike;

c) I propozon Këshillit profesional, përmes shefit të Sektorit dhe drejtorit, marrjen e masave profesionale për përmirësimin e organizimit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë.

25.4. Shefi i Sektorit, sipas nenit 11 të këtij Statuti, caktohet nga drejtori i QKMF – së, kryesues i Kolegjit profesional, dhe për punën e tij i përgjigjet kryeshefit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe drejtorit të QKMF - së .

Këshilli etik

Neni 26

26.1. Këshilli etik është trupë, e cila siguron kryerjen e veprimtarisë së QKMF - së mbi bazat e etikës dhe deontologjisë;

26.2. Anëtarët e Këshillit etik i emëron Këshilli drejtues;

26.3. Këshilli etik përbëhet nga 5 anëtarë:

- a) Pesë përfaqësues të QKMF-së (3 nga profesioni i mjekësisë dhe dy jashtë profesionit të mjekësisë);
- b) Një person i cili është jashtë profesionit të mjekësisë, nga shoqëria civile, i/e cili/a është individ i/e spikatur për punën shkencore ose shoqërore;
- c) 1/3 e anëtarëve të Këshillit etik duhet të jenë të gjinisë së kundërt.

Neni 27

27.1. Këshilli etik i QKMF - së i kryen këto punë:

- a) Përcjell zbatimin e veprimtarive etike dhe deontologjive në lëmin e shëndetësisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë në QKMF;
- b) Miraton kërkime shkencore në QKMF, sipas dispozitave ligjore që rregullojnë këtë lëmë;
- c) Shqyrton edhe çështje të tjera etike lidhur me veprimtarinë e QKMF- së.

27.2. Këshilli etik miraton rregulloren e punës së Këshillit.

27.3. Detyrat dhe përgjegjësitë e trupave tjera përcaktohen me akte nënligjore të nxjerra nga Këshilli drejtues, përmes drejtorit të QKMF - së, nëse ato nuk janë të përcaktuara me akte të tjera nga Ministria e Shëndetësisë.

Organizimi sindikal

Neni 28

28.1. Në QKMF mund të organizohet Organizata sindikale, ku punëtorët, me anëtarësimin e tyre vullnetar, do t'i realizojnë të drejtat dhe interesat e veta të garantuara me konventat ndërkombëtare të punës dhe me ligj.

28.2. Në rast të organizimit të grevës së punëtorëve, në QKMF duhet të sigurohet minimumi i kryerjes së detyrave të punës apo shërbimeve.

VII. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional

Neni 29

29.1. Në kuadër të QKMF - së ndërmerren masat për zhvillimin profesional për të gjithë punëtorët shëndetësorë, bazuar në dispozitat e Ligjit për shëndetësi dhe aktet tjera nënligjore që rregullojnë këtë lëmë.

29.2. Për mbajtjen e aktiviteteve nga pika 29.1, përgjegjës janë koordinatorët dhe trajnuesit e programeve për mjekësinë familjare dhe infermierinë familjare, të përcaktuar nga Qendra e Trajnimit të Mjekësisë Familjare dhe Qendra për Edukim të Vazhdueshëm Infermier pranë Ministrisë së Shëndetësisë, në bashkëpunim me QKMF-në, të cilët kanë përgatitje adekuate profesionale.

29.3. Titujt profesional do të njihen me sistematizimin e vendeve të punës në QKMF, dhe njëherësh do të gradohen sipas ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë këtë lëmë.

29.4. Financimi i ZHP - së të punëtorëve bëhet nga buxheti i QKMF - së dhe burimet në dispozicion.

VIII. Mbikëqyrja e QKMF - së

Neni 30

30.1. QKMF - ja i nënshtrohet mbikëqyrjes ligjore dhe profesionale, që sigurohet përmes organeve të autorizuara në bazë të këtij Statuti dhe dispozitave tjera ligjore.

30.2. Mbikëqyrjen në QKMF e bënë Këshilli mbikëqyrës i institucionit.

30.3. Formimi, përbërja dhe funksionimi i Këshillit mbikëqyrës, përcaktohet me udhëzime administrative të nxjerra nga Ministria.

30.4. Mbikëqyrja e brendshme e punës profesionale kryhet në mënyrën e paraparë me Rregulloren mbi mbikëqyrjen e brendshme, të cilën e nxjerr Këshilli drejtues i QKMF - së.

30.5. Mbikëqyrja dhe monitorimi i QKMF - së përfshin:

- a) Mbikëqyrjen dhe inspektimin e objekteve të shëndetit parësor lidhur me infrastrukturën dhe menaxhimin e objekteve;
- b) Mbikëqyrjen dhe inspektimin e ofrimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore sipas normave dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria;
- c) Mbikëqyrjen dhe monitorimin e raporteve dhe procedurave financiare lidhur me menaxhimin e fondit të alokuar, të paraparë nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Rregullat e prokurimit publik.

IX. Aktet e përgjithshme

Neni 31

Aktet e përgjithshme të QKMF - së janë: Statuti, rregulloret, urdhëresat dhe vendimet përmes të cilave rregullohen çështjet nga veprimtaria e institucionit.

Neni 32

Këshilli drejtues, me propozim të drejtorit, nxjerr këto akte të përgjithshme të QKMF-së:

- a) Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës;
- b) Rregulloren për përgjegjësinë disiplinore të punonjësve;

- c) Rregulloren për mbrojtje në punë;
- d) Rregulloren për mbrojtjen kundër zjarrit;
- e) Rregulloren për kontabilitetin e brendshëm;
- f) Rregulloren për rendin shtëpiak;
- g) Rregulloren për mbikëqyrjen e brendshme;
- h) Rregulloren për parandalimin e infeksioneve etj.

X. Pronësia, buxheti dhe financat

Pronësia

Neni 33

Pasurinë e QKMF - së e përbëjnë të drejtat dhe të mirat materiale që kanë qenë të evidencuara si pronë shoqërore, të cilat QKMF – ja ka pasur të drejtë t'i ketë në dispozicion nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit për shëndetësi në Kosovë.

Buxheti

Neni 34

34.1. Çështjet buxhetore dhe financiare të QKMF - së, administrohen në mënyrë transparente në pajtim me rregulloret mbi përdorimin e fondeve nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, si dhe me të gjitha procedurat në përputhje me udhëzuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave.

34.2. Buxheti dhe llogaritë e QKMF - së duhet t'i përfshijnë të gjitha shpenzimet operative të njësisve punuese.

34.3. Prokurimi i QKMF - së bëhet në përputhje me Ligjin e prokurimit publik në Kosovë.

34.4. QKMF – ja ia prezanton buxhetin vjetor për miratim Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

34.5. Drejtori mund të kërkojë revizion të jashtëm për monitorimin e shfrytëzimit të drejtë të mjeteve.

Financimi

Neni 35

35.1. QKMF - ja shfrytëzon burimet financiare, në përputhje me Ligjin për shëndetësi në Kosovë, nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe burimet tjera të parapara me ligjet përkatëse.

35.2. Bashkëpagesa për shërbimet e ofruar në QKMF, si burim i financimit të aktiviteteve të QKMF- së, do të bëhet në bazë të çmimores së miratuar nga Ministria e Shëndetësisë.

35.3. Për bashkëpagesat e shërbimeve shëndetësore që i ofron QKMF - ja, të cilat nuk janë të përfshira në çmimoren e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, Këshilli drejtues i QKMF- ës cakton çmimet e shërbimeve përkatëse.

35.4. QKMF - ja mund të nxjerrë akte të veçanta të detalizuara për llojin dhe shumën e pagesave të ndryshme, që do të jetë në pajtim me rregulloret përkatëse të nxjerra nga Ministria.

X.I. Transparenca në punë

Neni 36

Struktura, kushtet dhe mënyra e ofrimit të shërbimeve shëndetësore, si dhe kryerja e veprimtarisë së QKMF – së, janë publike dhe transparente ndaj personave juridikë, fizikë, përveç kur bëhet fjalë për sekret afarist dhe profesional.

Neni 37

Informatat dhe të dhënat mbi veprimtarinë, si dhe shikimi në dokumentacionin mbi veprimtarinë shëndetësore, personave të autorizuar apo mjeteve të informimit, mund t'iu japë vetëm drejtori ose punëtori i QKMF - së të cilin ai e autorizon.

XII. Konfidenca profesionale Sekreti afarist dhe profesional

Neni 38

Zbulimi i sekretit afarist konsiderohet dhënia e dokumentacionit dhe të dhënave të tjera në shikim personave të paautorizuar, veprim i cili do t'i shkaktonte dëm reputacionit dhe interesit afarist të QKMF - së.

Neni 39

39.1 Sekret afarist konsiderohen:

- a) Dokumentet të cilat drejtori i vlerëson si sekret afarist;
- b) Të dhënat të cilat organi kompetent i konsideron sekrete dhe ia ofron institucionit si të tilla;
- c) Masat dhe mënyra e veprimit në raste të krijimit të situatave të jashtëzakonshme;
- d) Dokumentacionin që përmban planin e mbrojtjes fiziko -teknike të punëtorëve dhe pasurisë së institucionit dhe
- e) Të dhënat tjera, publikimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me interesat e institucionit dhe themeluesit të tij.

Neni 40

40.1.Mos ruajtja e sekretit afarist konsiderohet shkelje e rëndë e detyrave të punës.

40.2.Për ruajtjen e sekretit afarist drejtpërdrejt kujdeset drejtori.

XIII Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 41

Aktet e përgjithshme, nga neni 31 dhe neni 32 i këtij Statuti, do të nxirren në afat prej 120 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Statuti.

Neni 42

Në ditën e hyrjes së këtij Statuti fuqi, shfuqizohet Statuti i QKMF-së i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut 01. nr. 93/06 i datës 31.07.2006.

Neni 43

Ky Statut hynë në fuqi pas miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut.

KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS
z. Xhelal Gashi

